



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:145309

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05411448

CPP.nr.18/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K... sh.a me seli në Prishtinë, kundër debitorit S.B, nga Vushtrri, lidhur me çështjen përmbarimore pagimi i Borxhit në shumë prej 1679,50 €, për periudhën kohore prej 04.10.2002-20.03.2013, duke rivendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga i biri i debitorit tani të ndjerë S.B, z.E.B, po ashtu nga Vushtrri, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit, jashtë seance, me datën 22.02.2024, e mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET i bazuar prapësimi i marrësit përsipër të procedurës përmbarimore E.B në vend të debitorit S.B, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri përmbarimor P.nr.105/20 i datës 03.02.2020 i lejuar nga Përmbaruesi Privat A.M në territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat A.M, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit të paraqitur me datën 03.02.2020 ka lëshuar Urdhër me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstrakteve nga librat afarist.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor është ushtruar prapësim nga i biri i debitorit E.B me të cilin e kundërshton urdhrin përmbarimor si të pa bazuar. I njëjti ndër të tjera thekson se debitori S.B ka vdekë me datën 01.10.2018 në Prishtinë, ku prapësimi i ka bashkangjitur edhe vërtetimin e vdekjes në emër të tij.

Kreditori në afatin ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar dhe duke theksuar se kreditori me debitorin me datën 29.08.2016 kanë lidhur kontratë mbi pagesën e borxhit ndërsa me datën 12.10.2019 debitori ka paguar këstin e 4-të tri vite pas pagimit të këstit të parë, me qka debitori ex lege e ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit konform nenit 368 të LMD-së ku përcaktohet se” Parashkrimi ndërpritet kur

debitori e pranon borxhin, ndërsa në par 2 të këtij neni theksohet se Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e debitorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë sikurse janë pagesa e këstit, kamatës, dhënia e sigurimit. Ka propozuar refuzimin e prapësimit të debitorit si të pa bazuar dhe mbetjen në fuqi të urdhërit përmbarimor.

Gjykata pas analizimi dhe rivlerësimit të prapësimit të ushtruar nga debitori, gjeti se prapësimi i të birit të debitorit është i Bazuar.

Gjykata nga propozimi për përmbarim konstaton se kreditori ka inicuar procedurën përmbarimore kundër debitorit S.B, me datën 03.02.2020, pranë Përmbaruesit Privat A.M në Vushtrri.

Nga vërtetimi i vdekjes në emër të debitorit S.B, vërtetohet se debitori S.B ka vdekur me datën 01.10.2018 në Prishtinë.

Në një situatë të tillë vërtetohet se kreditori ka inicuar procedurë përmbarimore kundër debitorit S.B rreth dy vite pas vdekjes së debitorit.

Nga të lartcekurat gjykata vjen në përfundim se urdhëri për lejimin e përmbarimit P.nr.105/20 i datës 03.02.2020 është lejuar kundër palës – debitorit S.B i cili në atë kohë veçse ishte i vdekur dhe në një rrethanë të tillë të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarrura kundër ish debitorit S.B ishin nule, e gjithashtu nuk qëndron gjithashtu pretendimi i kreditorit se debitori S.B ka paguar këstin e 4-të tri vite pas pagimit të këstit të pare.

Nga shkaqet e theksuara më lart rezulton se prapësimi i ushtruar nga i biri i debitorit është i bazuar në pajtim me nenin 73 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CPP.nr.18/24, datë: 22.02.2024

Gjyqtari
Izet Gërguri

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*

Numri i lëndës: 2021:145309
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05411448